

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Kuvendi komunal i Prizrenit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-26-5095-5-5-8**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me pajisje të teknologjise informative**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit *

ARITECH SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kilometri i 10 Prishtinë-Lipjan, përball QMI

(Adresa)

Graçanicë

10500

(Vendi)(Kodi postar)

+383 38 600 500

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Fahri Avdiu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

fahri@aritechks.com

(Adresa elektronike)

17.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

/_____
(Emri i avokatit)

/_____
(Adresa e plotë)

/_____
(Numri i Telefonit)

/_____
(Numri i faks-it)

/_____
(Adresa elektronike)

/_____
(Data e parashtrimit të ankesës)

/_____
(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ftese për ofertim kemi pranuar me: 25.06.2026.
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 10.07.2026.
Data dhe ora e hapjes së ofertave: 10.07.2026. ora 14:00
Njoftimi mbi vendimin e AK: 30.07.2026.
Kriter për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Procesverbalin e hapjes së ofertave e kemi pranuar në e-prokurim

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

Letren standarde per tenderuesin e pasuksesshem se bashku me njoftimin mbi vendimin e AK i kemi pranuar ne e-prokurim me 30.07.2026.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kerkesen për ri-shqyrtim të AK kemi dorëzuar më 04.08.2026.

Njoftimi për pezullimin e aktivitetit të prokurimit 04.08.2026.

Vendimin për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim e kemi pranuar 05.08.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28- Specifikimet teknike

Neni 52- Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 59- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi
tendereve

Neni 61- Tenderet jo-normalisht të ulët

Neni 60- Kriteret për dhenie të kontratës

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 19 i Rregullores për prokurim publik- Specifikimet teknike

Neni 40 i Rregullores për prokurim publik- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i
tendereve

Neni 41 i Rregullores për prokurim publik- Tenderet jo-normalisht të ulët

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ e rregulloren për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 30.07.2026 ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate OE INFINITT SH.P.K.

Me 30.07.2026 kemi derguar kerkese per qasje ne dokumente zyrtare dhe me 31.07.2026 AK na ka ofruar qasjen ne dokumentet e tenderit per projektin ne fjale.

Nga dokumentet te cilat kemi pranuar ne qasjen ne dokumente zyrtare konstatojme se AK ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem.

Konform nenit 6.2 te kontrates se AQP-se nr. UA/2016-23-6106-1-1-1/C403 deri C420 OE mund te aplikojne vetem me paisjet- brendin per te cilin kane dorezuar autorizim dhe jane kualifikuar ne AQP.

OE INFINITT SHPK eshte i kualifikuar me brendin HP ndersa per kete aktivitet te prokurimit fare nuk ka dorezuar specifikimin teknik dhe katalogun e produkteve te ofertuara.

Ne mareveshjen publike kornize (baze per kete ftese per ofertim) shprehimisht kerkohet qe: per secilin produkt duhet te specifikohet emri i modelit qe ofertoni. Ne kolonen e pare te secilit produkt tek Prodhuesi- Brand name duhet te shkruani emrin e modelit duke perfshire emrin e prodhuesit dhe emrin e sakte te modelit qe ofertoni

Sipas Udhëzuesit nr. 001/2023 per Prokurim publik pika 10- Sqarimi i tendereve gjate procesit te vleresimit te tendereve – Nese mungon specifikacioni teknik per mallrat e ofruara dhe katalogu (specifikimi teknik- AK percakton kerkesat minimale dhe maksimale te nje produkti, ndersa OE duhet te dorezoj specifikimin e detajuar te mallrave te ofruara. Perveq ne raste kur OE nuk mund te dorezoj specifikimin teknik te nje produkti te caktuar p.sh peme/perime etj. OE dorezon deklaraten ku deklarone se mallrat do te jene ne perputhje me specifikimin e kerkuar atehere AK duhet te veproje konform udhezimit dhe rregullores per prokurim publik duke refuzuar tenderin pa kerkuar informacion te metutjeshem, bazuar ne nenin 28 te LPP-se.

Ne baze te specifikimeve teknike te hartuara per pozicionin 4 eshte kerkuar Skaner Canon, OE ne fjale nuk eshte i kualifikuar ne AQP per te ofertuar produkte te brendit Canon per vetem HP, AK para se te rekomandoj per kontrate eshte dashur te kerkoje sqarime shtese broshurat e produkteve pasi qe eshte dyshese se projekti do te realizohet ne teresi sipas specifikimeve teknike te parashtruara ne ANEKS 1 te FPO-se.

Per raste te ngjashme jane leshuar vendime te OSHP-se ne te kaluaran, si prove cekim vendimin nr. 214/22

AK eshte dashur te trajtoje oferten e OE INFINITT SHPK si jo-normalisht te ulet pasi qe bazuar ne cmimin total te dhene nga OE dhe kerkesat e parashtruara ne kemi dyshime se mund te realizohet projekti sipas specifikimeve teknike ne kerkese pasi qe vlera e produkteve- kosto eshte reth 20% me e larte se buxheti i planifikuar per kete projekt rjedhimisht jemi detyruar te kerkojme qasje si pale me interes ne kete projekt.

Konform nenit 61 te LPP-se dhe nenit 41 te rregullores per prokurim publik AK eshte dashur te trajtoje oferten e OE ne fjale si jo-normalisht te ulet siq parashihet ne dispozitat ligjore ne fuqi kur tenderet ne shikim te pare duken jo te besueshem nese krahasohet me objektin e kontrates.

AK/zyra e prokurimit eshte dashur qe konform nenit 61.2 te LPP-se te trajtoje oferten

e OE INFINITT SH.P.K. dhe te zhvilloje proceduren inter partes per te kerkuar deshmi konform dispozitave ligjore:

2.1 ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

2.2 çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

2.3 çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

2.4 origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Sipas LPP-se dhe Rrpp ky OE eshte dashur te eleminohet nga procedura e prokurimit, per shkak se nuk eshte i pergjegjshem ne aspektin administrativ.

Mare parasysh faktet e lartcekura konstatojme se AK/komisioni vleresues ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem i cili ne baze te ofertes se dorezuar nuk ploteson specifikimet teknike per PC dhe ka ofruar produkte nga prodhues per te cilet nuk eshte kualifikuar ne ofertim ne AQP.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e shkeljeve të lartëcekura nga AK/ komisioni vlereses ka ardhe deri te dhenia e kontrates per OE te papergjegjshem, ne kete menyre nuk jane respektuar dispozitat ligjore te lartcekura dhe kompanise sone i eshte mohuar fitimi i nje kontrate publike si dhe fitimi simbolik i paramenduar nga kjo kontrate.

Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*